



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut

Nr. 207 prot.

Fushë-Arrëz, më 24. 01. 2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion i Komisionit të Përhershëm të Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut lidhur me shqyrtimin e projekt/vendimit "Miratimi i listës emërore të përfituesve të subvencionimit me qira" i cili që do t'i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqerisjen vendore", i ndryshuar, Rregullores për Funksionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale, në mbledhjen e datës 24.01.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Tereze Dema, Franc Doda dhe Pavlin Qafa, mori në shqyrtim projektin për listën emërore të përfituesve të subvencionimit me qira.

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor, ndërkohë në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Drejtoresha e Emigracionit e Çeshtjeve Sociale, zj.Sidorela Katroshi, e cila shpjegoi se: Lista përfituese është bërë në bazë të VKM Nr. 362 date 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" ku përparësi në subvencionimin e qirasë, sipas VKM nr.384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", kategoritë e përcaktuara në nenet 33 dhe 34/3 të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" si më poshtë: a)Individët me statusin e jetimit, b) personat me aftësi të kufizuara, c) Të moshuarit, d) Invalidët e punës, Emigrantët e rikthyer, dh) Familjet e policëve të rënë në detyrë, e) Puntori emigrant, ë) Azil-kërkuesit, f) Familjet e komunitetit Rom, g) Familjet e komunitetit Egjiptian, gj) Viktimat e dhunës në familje, h) Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, i) Prindërit e vetëm , që kanë në ngarkim fëmijë, j) Individët, që i përkasin komunitetit LGBTI, k) Të mitur, 14-18 vjeç,dhe të rinj, 18-21 vjec, në konflikt me ligjin, l)Vajzat nëna, pas daljes nga programi banesave sociale të specializuara, ll) Familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas Aktit Normativ me Fuqinë e ligjit Nr.3, date 1.3.2012.

Masa e subvencionimit të qirasë për çdo familje është llogaritur sipas pikës 5 të VKM Nr.362 dt.29.5.2019.

Masa e subvencionimit të qirasë është e barabartë si diferencë ndërmjet qirasë reale, që paguan familja, dhe aftësisë paguese së familjes për të përballuar pagimin e qirasë e cila llogaritet për 12 muajt e fundit, Aftësi paguese ,pra qiraje e përballueshme është ajo pjesë e qirasë , të cilën familja/individit arrin ta paguaj me të ardhurat e veta dhe që zë jo më shumë se:

- a) 25% të të ardhurave të një familjeje me të ardhura mesatare ;
- b) 20% të të ardhurave të një familjeje me të ardhura të ulëta
- c) 15% të të ardhurave të një familjeje me të ardhura shumë të ulëta.

Anëtarët e komisionit shprehen njëzëri për dakordësinë duke qenë se ky projekt iu vjen në ndihmë familjeve në nevojë, projekt ky i bërë për herë të parë nga ana e zyrtarëve të bashkisë Fushe-Arrez për komunitetin sipas ligjit në fuqi.


Anëtarët e komisionit, me shumicë votash, kanë dakort me projektin për për listën emërore të përfituesve të subvencionimit me qira për vitin 2025 sipas listës emërore të përfituesve të subvencionimit me qira të paraqitur dhe kërkuar miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak në mbledhjen plenare të datës 27.01.2025 duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

Franc Doda



Pavlin Qafa



Tereze Dema